

VENDIM
Nr. 805, datë 26.11.2014

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.545, DATË 11.8.2011, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE CIVILË/NËPUNËSVE, ZËVENDËSMINISTRIT DHE NËPUNËSVE TË KABINETEVE, NË KRYEMINISTRI, APARATET E MINISTRIVE TË LINJËS, ADMINISTRATËN E PRESIDENTIT, KUVENDIT, KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE, PROKURORINË E PËRGJITHSHME, DISA INSTITUCIONE TË PAVARURA, INSTITUCIONET NË VARËSI TË KRYEMINISTRIT, INSTITUCIONET NË VARËSI TË MINISTRAVE TË LINJËS DHE ADMINISTRATËN E PREFEKTIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4/2, të ligjit nr.10405, datë 24.3.2011, "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve", të nenit 7, të ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", të ligjit nr.9584, datë 17.7.2006, "Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj", dhe të ligjit nr.185/2013, "Për buxhetin e vitit 2014", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.545, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në pikën 1/1, emërtesat "Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" dhe "Komisioni i Shërbimit Civil" zëvendësohen, përkatësisht, me "Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale" dhe "Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil".

b) Në fund të pikës 1/2 shtohet emërtesa "Qendra e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA)".

c) Në fund të lidhjes nr.3, që përmendet në pikën 3, shtohen dy ndarje, me këtë përmbajtje:

– Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, – inspektorë të ankesave dhe hetimit administrativ, kategoria III-a;

- Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil – inspektorë, kategoria III-b.".

ç) Në lidhjen nr.9, që përmendet në pikën 13, emërtesat "Kryeinspektor në inspektoratet e mbrojtjes së tokës në qarqe" dhe "Inspektor në inspektoratet e mbrojtjes së tokës në qarqe" shfuqizohen.

d) Në lidhjen nr.9/4, që përmendet në pikën 13/4, në ndarjen me kategorinë e pagës III-a/1, pas fjalëve "...Tiranë 3..." shtohen "...Tiranë 4 (zona turistike)...".

2. Efektet financiare të këtij vendimi për:

- Qendrën e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) dhe Drejtorinë e ALUIZNI-t, Tiranë 4 (zona turistike), të fillojnë nga momenti i emërimit në detyrë të nëpunësve të kësaj qendre.

-Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, të fillojnë nga momenti i miratimit nga Kuvendi i strukturës dhe organikës së secilit institucion.

- Parashikimet e tjera të fillojnë nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

3. Efektet financiare të këtij vendimi, për vitin 2014, të përballohen nga fondet e miratuara për secilin institucion për vitin 2014.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama